


KËRKESË ANKIMORE – PËRPARA KAS

Tiranë – Datë 29.05.2025



ANKUESI	
Subjekti Ankues	Adresa, posta elektronike dhe/ose nr. i telefonit Tel: 0697839115
KOALICIONI "PARTIA DEMOKRATIKE-ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE" (PD-ASHM)	

OBJEKTI I ANKIMIT	
1. Kundërshtimi i Vendimit Nr. 1326, datë 24.05.2025 – të KSHZ - "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të votimit në zonën zgjedhore Qarku TIRANË, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025" 2. Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 11 maj 2025 në zonën zgjedhore Qarku-Tiranë. Zgjidhjen e pasojave duke urdhëruar përsëritjen e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Tiranë. 3. Sipas rastit, rivlerësimin dhe/ose rinumërimin e votave të Zonës Zgjedhore – Qarku Tiranë.	
Vendimi	TITULLI I VENDIMIT "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të votimit në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025"
Nr.	Datë
1326	24.05.2025
1. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të votimit për subjektet zgjedhore në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëngjitet këtij vendimi ; 2. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të votimit për kandidatët për deputetë në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 11 maj 2025, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëngjitet këtij vendimi ... ;	
Baza Ligjore: Nenet: 3, 8, 19, pika 1, 21, pika 1, gërma "a", neni 25, 25/1, 25/2, 26 pika 2, neni 39, pika 2, nenet 115, 116, 117, 118, 119, 121, 123, 123/1, 123/2, 123/3, 124, 125, 127, 133, 136, 137, 138, 139, 140, 141, 143, 160, 161 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.	

NË LIDHJE ME PROCEDURËN DHE KONTESTIMIN

A. Në lidhje me legjitimitimin e palës ankuese



nënshkrimi i Ankuesit

Neni 123 i Kodit Zgjedhor parashikon se nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për Zgjedhjet për Kuvend, behet nga KQZ. Për këtë, KQZ plotëson Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore dhe e miraton atë me vendim jo më vonë se 48 orë nga mbërritja e të gjitha tabelave të zonës zgjedhore, pra ne rastin konkret të Qarkut perkates.

Në çdo rast Tabela Përmbledhëse e Rezultatit për Zonën Zgjedhore, sipas këtij neni, nuk mund të miratohet nga KQZ, pa numëruar të gjitha kutitë e pranuar të rregullta, sipas këtij Kodi, në të kundërt vendimi i miratimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, sipas këtij neni, është i pavlefshëm.

Kur gjatë hartimit të tabelës, sipas pikës 1 të këtij neni, KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të palëve, vëren mospërputhje të shifrave të votave për subjektet të tabelës së rezultatit të ZAZ-së me tabelat e rezultateve të qendrave të votimit, merr vendim për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore me shifrat e korrigjuara, duke u bazuar në origjinalet e tabelave të qendrave të votimit. Një kopje e vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore u jepet të gjitha subjekteve zgjedhore që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e zonës zgjedhore përkatëse.

Vendimi i KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, sipas këtij neni, mund të ankimohet po në KAS, sipas procedurave të parashikuara në pjesën X të këtij Kodi.

Referuar Nenit 123/1 të Kodit Zgjedhor, parashikohet e drejta për të vënë në lëvizje KQZ, si një e drejte që i njihet subjekteve zgjedhore, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së.

Sipas pikes 2 të këtij Neni, kërkesat ose ankesat e subjekteve zgjedhore trajtohen sipas procedurës së përcaktuar nga ky ligj dhe nga aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Kërkesat, ankesat, informacionet, propozimet apo denoncimet e palëve të treta trajtohen sipas procedurës së përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe sipas afateve që përcakton KQZ-ja me akt nënligjor.

Ndërsa, neni 124, pika 3 parashikohen qarte se Kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, të marrë sipas nenit 123 të këtij Kodi, mund të paraqitet ankim po në KQZ jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e këtij vendimi. Ankimi ndaj vendimit mund të përmbajë ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi. Nderkohe në bazë të Nenit 124/6 i Kodit Zgjedhor, përcaktohet se: *“Në shqyrtimin e kërkesave ankimore të paraqitura, KQZ-ja shqyrton të gjithë problematikën e tyre, përfshirë edhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendra të caktuara votimi, pa u kufizuar në objektin e kërimit të kërkesës ankimore të paraqitur nga subjekti zgjedhor”*.

- Zgjedhjet për Kuvend u caktuan në datën 11 Maj 2025, me dekretin e Presidentit të Republikës.

- Me Vendimin perkates, KQZ regjistroi subjektin zgjedhor “Partia Demokratike”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025” ;

- Me Vendimin perkates, KQZ regjistroi subjektin zgjedhor, “PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE” (PD-ASHM), të kryesuar nga Partia Demokratike (PD), për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e përgjithshme të 11 Majit 2025.




Nënshkrimi i Ankuesit

Për shkak se çënohen interesat tona të ligjshme, PD-ASHM e kundërshton këtë tabelë përmbledhëse të rezultateve për Qarkun Tiranë, për shkaqet dhe arsyet që do të paraqiten në vijim.

Duke qenë se jemi subjekt zgjedhor i regjistruar rregullisht në zgjedhjet e 11 majit 2025, si dhe duke qenë se ankimi jone paraqitet brenda afatit 5-ditor nga e nesërmja e shpalljes së tabelës përmbledhëse të rezultateve nga KQZ, ne kemi legjitimitet të plotë për shqyrtimin e kësaj kërkesë ankimore përpara KAS.

B. Në lidhje me kompetencën e organit administrativ

Neni 12, pika 5 e Kodit Zgjedhor parashikon se Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (në vijim “KAS”) është organi kompetent për shqyrtimin e ankimeve administrative. Neni 21, pika 1, gërma “a” parashikon se KAS-i vendos për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në një ose më shumë zona zgjedhore apo në të gjithë vendin, si dhe përsëritjen e pjesshme ose të plotë të zgjedhjeve. Ndërsa, neni 123, 124 e vijues të Kodit Zgjedhor parashikon se vendimet për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit Zgjedhor ankimohen në KAS.

Me Vendimin objekt ankimi është vendosur miratimi i Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për Subjektet dhe kandidatët për Zgjedhjet për Kuvend të 11 majit 2025 në Qarkun Tiranë. Në zbatim të Kodit Zgjedhor, çdo subjekt zgjedhor ka të drejtë të paraqesë ankim kundër vendimit për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultatit zgjedhor, brenda afatit ligjor prej 5-ditësh.

Në këtë kuptim, Koalicioni “PD-ASHM” përmbush kriterin e dytë procedural, kompetencën lëndore, për shqyrtimin e këtij ankimi.

C. Në lidhje me afatin e paraqitjes së ankimit

Kriteri i tretë për paraqitjen e një ankimi administrativ kundër vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit Zgjedhor ka të bëjë me afatin ligjor të ankimit. Për këtë, neni 124, pika 3 ka parashikuar shprehimisht që kundër vendimit të KQZ për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit, mund të bëhet jo më vonë se 5-ditë nga shpallja e këtij vendimi.

Në rastin konkret, vendimi objekt ankimi është shpallur nga z. Celibashi në datë **24.05.2025**. Ankimi është paraqitur brenda afatit 5-ditor duke nisur nga e nesërmja e vendimit të atakuar, të parashikuar nga dispozitat perkatese të Kodit Zgjedhor. Në këtë kuptim, Koalicioni “PD-ASHM” përmbush kriterin e tretë procedural, afatin ligjor për paraqitjen e këtij ankimi.

Konkluzion: Neni 130 i Kodit Zgjedhor përcakton se KQZ merr vendim për pranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon: a) kompetencën e KQZ-së; b) legjitimitimin e ankuesit; dhe c) respektimin e afateve ligjore. Duke qenë se sic kemi shpjeguar më lart, ankimi i paraqitur nga PD-ASHM përmbush të tre kriteret procedurale (*legjitimitimin, kompetencën dhe afatin ligjor*), kërkojmë nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore të paraqitur nga Koalicioni “PD-ASHM” lidhur me zgjedhjet e 11 Maj 2025 të zhvilluara në Qarkun Tiranë.



PËRSHKRIMI I SHKELJES SË PRETENDUAR

Në shkëmbim të Ankuesit

Zgjedhjet për Kuvend u caktuan në datën 11 Maj 2025, me dekretin e Presidentit të Republikës.

Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave në Qarkun objekt ankimi, KQZ miratoi tabelat përmbledhëse të rezultateve për subjektet dhe kandidatë për Zgjedhjet për Kuvend, sipas tabelës bashkëngjitur vendimit të atakuar.

Koalicioni PD-ASHM, ka ardhur në dijeni të fakteve, indicieve dhe ka siguruar prova të mjaftueshme lidhur me problematika dhe parregullsi të rënda të procesit zgjedhor të ndodhura në thuajse të gjitha Qendrat e Votimit të Qarkut Tiranë.

Në Qarkun Tiranë, përdorimi masiv i administratës publike dhe i strukturave shtetërore, përfshirë dhenia e bonuseve apo avantazheve në natyrë ndaj shtresave të ndryshme sociale, në funksion të interesave elektorale të Partisë Socialiste në pushtet prej 12 vitesh tashme, ka qenë i përhapur kudo, **duke krijuar një mjedis totalisht në favor të partise në pushtet, duke deformuar garenë zgjedhore në një ndeshje krjtesisht të pabarabartë, jo-transparente dhe diskriminuese ndaj opozitës.** Keto institucione, sipas Kushtetutës dhe ligjit, duhet të ruajnë neutralitetin politik, përfshirë shpesh here administratën e bashkive, agjencitë shtetërore, entet publike dhe ndërmarrjet janë vënë në mënyrë të hapur në shërbim të partisë në pushtet. Praktikisht, thuajse të gjitha bashkitë e Qarkut drejtohen nga PS, dhe keto të fundit, së bashku me kryetarët e tyre dhe administratat përkatëse, janë angazhuar gjatë gjithë periudhës parazgjedhore dhe asaj zgjedhore në mbështetje të listës së kandidatëve për deputetë të Partisë Socialiste në Tiranë.

Veprimtaria e strukturave publike në fakt, nisi heret këtë vit, që në muajin Janar, nën thirrjen për regjistrimin e emigrantëve, në **“fushatën për regjistrimin e Diasporës”** që filloi në 11 Janar 2025 me hapjen e PER nga QKZ. Jo se nuk kishte aktivitet edhe përpara kësaj date, por me 11 janarin kulmoi edhe puna në terren dhe jashtë vendit të tyre. Kjo përfshiu organizimin e takimeve intensive jo vetëm brenda vendit, por edhe në Itali, Greqi, SHBA, Mbretërinë e Bashkuar, France, Belgjike, Kanada por edhe në vende të tjera ku jetojnë emigrantë shqiptarë. Partia Demokratike ka denoncuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve një sërë rastesh ku funksionarë publik të Qarkut Tiranë janë përfshirë personalisht në procesin e regjistrimit të qytetarëve në platformën PER, duke abuzuar me detyrën dhe duke shkelur çdo normë të ndarjes së administratës nga përfshirja e saj aktivisht në fushata politike, propagande, mbledhje votash etj.

Në këto kushte, pjesa më e madhe e administratës vendore dhe qendrore, në vend që të përmbushte detyrimet e saj funksionale ndaj qytetarëve, u përfshi drejtpërdrejt në aktivitetet elektorale të Partisë Socialiste. Zyrtarët lokalë kishin objektiva të qarta dhe synime të përcaktuara për numrin e votuesve që duhej të mobilizonin apo garantonin personalisht, duke e kthyer Shtetin në një instrument të fushatës së mazhorancës. Si pasojë, qytetarët e Qarkut Tiranë nuk kanë marrë shërbimet publike të nevojshme gjatë kësaj periudhe, sepse për më shumë se katër muaj (nga Janari gjer në Maj), administrata ishte zhvendosur dhe fokusuar tërësisht në funksion të axhendës elektorale të partise-Shtet, të shefave apo drejtorëve të tyre, një pjese e mirë e të cileve ishin edhe kandidatë për deputetë si në Tiranë, apo edhe në qarqe të tjera. Të shumta janë rastet ku jo vetëm drejtorët, por edhe specialiste të thjeshtë rezultojnë se kanë marrë lejen vjetore mbi 3-4 javë në këto faze, jo për pushime dimri apo pranverë, jo për ç’lodhje apo udhetime, por pikërisht për të qenë aktiv në zgjedhje dhe për t’u angazhuar teresisht në fushatë zgjedhore.

Kjo situatë ka shuar praktikisht çdo kufi mes interesit publik dhe interesit partiak, duke minuar themelet e konkurrencës së ndershme dhe të barabartë në një proces që duhet të ishte demokratik. Në një realitet ku Partia-Shtet (PS) përdor të gjithë aparatet administrativ publik si makineri elektorale, opozita nuk përballlet më me një kundërshtar politik të organizuar si parti politike, por konfrontohet me një sistem të tërë që e kthen garën në një farsë. Në këto kushte, zgjedhjet e lira dhe të ndershme mbeten thjesht një iluzion.

Farsa elektorale që ne duam të denoncojmë publikisht është pikërisht kjo: Në Shqipëri opozita nuk hyn në garë me një fushatë të lirë dhe të ndershme, por përballlet me një kundërshtar që gëzon të gjitha



resurset shtetërore apo publike, si dhe mund të angazhojë edhe resurse private pa limit në dispozicion sa here i nevojitet. Ndërkohë që partia në pushtet ka në dispozicion buxhetin e Shtetit, buxhetet e gati 90% të bashkive në rang vendi, rrjetin e administratës jashtëzakonisht të fryrë, (duke mbajtur shpesh here vende pune fiktive si në ujesjellesa apo sherbime mbeshtetese etj), si dhe duke përdorur strukturat policore etj., si instrumente trysnie, nderkohe që subjektet opozitare operojnë me fondet e tyre të kufizuara dhe pa akses. Edhe në media, aksesit i opozites është mjaft i kufizuar, shtuar kjo edhe censura, autocensura, mbyllja e rrjeteve sociale si ai TikTok vetëm 60-dite para zgjedhjeve. Madje, raporti i OSBE-ODIHR është tejte kritik ndaj kontrollit, censures së medias apo auto-censures së saj. Kjo krijon një disproporcion të skajshëm në kapacitet, dukshmëri dhe aftësi mobilizimi të Opozitës.

Në këtë kontekst, zgjedhjet në Shqipëri nuk janë më një mekanizëm përfaqësues i demokracisë, por një **Farsë Elektorale** ku rezultati parapërcaktohet nga instrumentet e Shtetit dhe pushtetit, i cili here pas here mbeshtetet edhe tek grupet kriminale.

Së pari, dhënia e bonuesit të mbi 700.000 mijë pensionistëve shqiptarë nga Qeveria, miratuar me akt në Janar 2025, por që zbatimi i tij u shtri nga muaji Mars deri në Prill 2025, ishte një pipule e shtrenjte elektorale, e cila, duke akorduar mesatarisht deri në 100 Euro për pensionistë pak jave para zgjedhjeve, në kushtet kur pensioni mesatar në vend nuk e tejkalon shifrën e 300 Euro në muaj, përbente padyshim një incentive jashtëzakonisht të fortë në favor të Partisë-Shtet (PS), e cila u perkthye me pas edhe në mbeshtetje elektorale dhe në votë nga një pjesë jo e vogël pensionistësh, të cilët duhet thënë janë në meshirë të fatit dhe të braktisur nga Shteti, dhe që mbijetojnë shumica nga remitancat e femijëve apo të afërmeve të tyre në emigracion. Lemosha që hedh Qeveria çdo 2 vite tashme, sa here ka zgjedhje, shërben si opium që përgjum këto shtrese vulnerabel të shoqërisë tonë, me qëllimin që të harrojnë vuajtjet dhe veshtiresitë e jetesës të paperballueshme në Shqipëri. Nderkohe Opozita e ka denoncuar këtë fakt në KQZ dhe jo vetëm, por institucionet ligjzbatuese nuk kanë marrë asnjë masë kundër kesaj nisme e cila qartazi përdoret si një levë e fuqishme elektorale nga Partia-Shtet.

Së dyti, Falja e borxheve, amnistia e një game të gjere detyrimesh me VKM-ne e datës 9 Maj 2025, vetëm 2 dite nga zgjedhjet, e kryer nga Qeveria Shqiptare, një akt ky **totalisht në kundërshtim me Aktin Rregullator të Vitit 2020 të KQZ i cili ndalon kategorikisht 4 muaj para zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, propozimin e apo marrjen e vendimeve për amnisti apo falje detyrimesh financiare ndaj shtresave të popullsisë**, si dhe me keq akoma, mos marrja e masave urgjente për pezullimin / bllokimin e kesaj nisme nga KQZ (edhe pse u vu në levizje me ankimim urgjent nga PD-ASHM brenda datës 09.05.2025), deshmon për një kapje totale të Shtetit, një nivel sigurie absolute që shkelja e ligjit me të dy kembet nga vete Qeveria por edhe nga KQZ, nuk do t'i kushtojë asgjë në raport me ligjin, por vetëm do t'i sillte Partisë-Shtet benefite dhe avantazhe politike dhe elektorale të jashtëzakonshme, të paperllogaritshme. Pa cekur këtu faktin se këto nisma ishin një nga premtimet kryesore të Opozitës në Fushatë dhe rrjedhimisht kompjimi i tyre demtonte drejtpërdrejtë edhe PD-ASHM.

Edhe Raporti i Gjetjeve Paraprake të OSBE-ODIHR i datës 12 Maj 2025, pra me pak se 24 ore pas mbylljes së kutive të votimit ka evidentuar problemet serioze, të tilla:

Në raportin e OSBE-ODIHR për zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025, zona e Qarkut Tiranë, dokumenton disa raste, përmendet në disa kontekste të rëndësishme:

Me konkretisht, rastet e dokumentuara si shkelje të rregullave të procesit-zgjedhor në Tiranë, janë:



1. Përdorimi i burimeve shtetërore në Tiranë

Një nga bashkitë që përfshiu projekte subvencionesh gjatë fushatës ishte Tirana, çka përmendet në raport si pjesë e praktikave problematike të shpërdorimit të burimeve publike gjatë periudhës zgjedhore.


Mëshkrimi / Ankuesit

2. Presion dhe intimidim në Tiranë

Në Tiranë u raportuan:

- Se 20 staf të KQV-ve në Njësinë 8 në Tiranë u tërhoqën për shkak të presionit. Raporti i referohet këtij rasti si një shembull i mungesës së garancive për integritetin e stafit zgjedhor.

3. Pretendime për lidhje me kercenime dhe presion ndaj votuesve

ODIHR raportoi për pretendime për intimidim dhe presion

- Tirana përmendet si një nga qytetet ku u raportuan raste konkrete të kërcënimeve dhe presioneve ndaj votuesve për të votuar për Partinë Socialiste. Këto veprime bien ndesh me standardet ndërkombëtare për zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Në përmbledhje, Qarku Tirane është një prej zonave ku ODIHR ka evidentuar problematika serioze që lidhen me:

- Keqpërdorimin e burimeve shtetërore,
- Presione dhe frikësim ndaj administratës dhe votuesve.

Probleme të shumta kanë ndodhur në Qarkun Tirane gjatë fushatës, ditën e zgjedhjeve, por edhe gjatë numerimit të votave. Nder të tjera mund të veçojmë keto raste si disa nga ato me flagrantet:

1/ Intimidimi i Votuesve në VORE dhe kontronfimi me eksponentet e lartë të PD aty i personave me precedentë penale apo personave të paautorizuar nga KQZ. Rasti i incidenteve në Vore gjatë ditës së votimit ishte padyshim një nga rastet të cilat terhoqën vëmendjen e mediave dhe opinionit publik gjatë 11 Majit, sepse treguan kushtet në të cilat votuan qytetarët e Qarkut kryesor të vendit, Qarkut të Tiranës. Grupe me individë të njohur si të fortet apo të “plotefuqishmit” e qytezës së Vores, qendronin para qendrave të votimit të grumbulluar aty në vërtetim të procesit, kush vinte, kush ikte, kush votonte e kush jo. Pas incidenteve me drejtuesit politikë dhe eksponentet e PD, dhe pas apeleve të PD drejtuar KQZ për të thirrur nderhyrjen e Policisë së Shtetit dhe heqjen / anulimin e badge të vezhguesit ndaj personave të paautorizuar, KQZ nuk pranoi të therriste apo t’i bente apel publik nderhyrjes së policisë së shtetit për të vendosur rend dhe siguri në ato QV në Vore, por KQZ pasditen e 11 Majit, vendosi thjesht tërheqjen dhe anulimin e badge të vezhguesve [Referohu Vendimit të datës 11 Maj të KSHZ].

2/ Te njëjtin veprim (anulimin e badge të të gjithë vezhguesve) KQZ e bëri në ora 17.30 edhe për incidentet e QV tek shkolla Kongresi i Manastirit në Tiranë, [Referohuni vendimit përkatës të KSHZ, datë 11 Maj] pas problematikave aty, ku ishin prezent me dhjetra persona të paautorizuar që rrinin e ushtronin presion qoftë me prezencën e tyre shumë pranë QV. Në mungesë të prezencës së policisë në QV, si dhe kushtet kur Policia as pergjigjej dhe as shkonte pranë QV problematike, u desh anulimi i gjithë badge të vezhguesve në gjithë zonën, që të bëhej e mundur pastrimi i ambienteve dhe largimi deri diku i personave problematike që rrinin e ushtronin trysni dhe presion ditën e zgjedhjeve, në Kryeqytet.



3/ Zbulimi i Zyrrave Pa Logo të PS në Kryeqytet dhe incidentet përkatëse [Rasti i Petro Nini, Atir dhe Yzberish]:

Rasti i Zbulimit të Zyrrave Ilegale të PS tek Petro Nini Luarasi: Më 11 maj 2025, në një deklaratë për mediat, Belind Këlliçi denoncoi ekzistencën e një zyre elektorale të padëklaruar të Partisë Socialiste pranë shkollës “Petro Nini Luarasi”, të cilën ai e cilësoi si “rast të paprecedentë”. Sipas tij, deputeti


Belind Këlliçi

Erion Braçe pretendonte se ishte zyra e tij e punës, ndërkohë që disa të rinj, përfshirë një drejtoreshë të një institucioni shtetëror, u larguan me shpejtësi nga ambienti sapo u pikasën nga përfaqësues të PD-së dhe gazetarë. Brenda zyrës, Këlliçi pretendon se u konstatuan persona që punonin me laptopë, me harta dhe lista, duke përfshirë edhe një dyshim për blerje votash dhe shantazh ndaj votuesve.

Këlliçi denoncoi gjithashtu se përfaqësuesit e opozitës kishin kontaktuar gjashtë herë Policinë e Shtetit, e cila mbërriti vetëm pas 30 minutash në vendngjarje. Gjatë kësaj kohe, personat e pranishëm në ambient thuhet se paketuan materialet dhe u larguan me vrap, gjë që është filmuar nga mediat. Sipas tij, në ambient ndodhej edhe një person me precedent kriminal që shoqëronte deputetin Braçe. Opozita ka kërkuar që ambienti të konsiderohet si skenë e mundshme e një krimi elektoral dhe të hetohet plotësisht. [<https://reporteri.net/instant/tension-ne-tirane-pd-akuzon-ps-per-shkelje-te-kodit-zgjedhor-prane-shkolles-petro-nini/>]

Rasti i Zyres Elektorale Ilegale te PS ne Astir: Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka akuzuar Partinë Socialiste për hapjen e zyrave elektorale ilegale në Tiranë, të cilat ai i cilësoi si “**çerdhe të krimit elektoral**”. Pas incidentit pranë shkollës “Petro Nini Luarasi”, ku u përfshi edhe deputeti Erion Braçe, Berisha deklaroi se një tjetër zyrë e tillë u zbulua në **zonën e Astirit nga strukturat e PD-së**. [<https://www.balkanweb.com/berisha-akuza-ps-po-zbulohen-cerdhe-krimi-elektorale-pas-petro-ninit-zyre-ilegale-dhe-ne-astir/#gsc.tab=0>] Ka dyshime të arsyeshme se keto zyra po përdoren për manipulim të procesit zgjedhor, ose me qëllim për të ndikuar padrejtësisht në rezultatin e zgjedhjeve.

Rasti i Zyres Elektorale Ilegale te PS ne Yzberish: Kandidati i PD-së, Klevis Balliu, deklaroi për News 24 se disa incidente serioze të ndodhura në Tiranë dhe Vorë gjatë ditës së votimit, si përplasja e Flamur Nokës në një qendër votimi dhe zbulimi i zyrave të padeklaruara të PS-së pranë qendrave të votimit në Yzberisht, janë prova të aktiviteteve të paligjshme elektorale të Partisë Socialiste. Sipas Balliut, persona të lidhur me PS u panë duke u larguar me vrap dhe me kapuç në kokë kur u zbuluan nga përfaqësues të opozitës, duke përforcuar dyshimet për manipulim. Ai theksoi se këto janë veprime të një regjimi që po jep shpirt, ndërsa patronazhistët, sipas tij, janë ekspozuar dhe qytetarët tashmë i njohin [Sipas informacioneve tona për këto rast, ka patur edhe kallezim penal të depozituar]. [<https://www.panorama.com.al/vetem-nje-parti-ilegale-hap-zyra-ilegale-gjate-fushates-klevis-balliu-patronazhistet-u-pane-sot-ne-tirane-te-maskuar-me-kapuc-duke-ikur-me-vrap/>]

4/ Patronazhistet e PS ne Njesine nr 8 Tirane, ne aksion ditën e zgjedhjeve tek Shkolla e Kuqe.

Partia Demokratike ka denoncuar publikisht praninë e grupeve të patronazhistëve pranë Shkollës së Kuqe në Tiranë, (Njesia nr. 8), të cilët akuzohen për shantazh ndaj votuesve gjatë ditës së zgjedhjeve. Sipas PD-së, grupi përbëhet nga individë të lidhur me Partinë Socialiste, mes tyre Doria Zana dhe Geri Kusi, Edmond Gorezi dhe Ivi Shazivari, disa prej tyre edhe tek lista e patronazhistëve, të cilët, sipas denoncimit, ushtrojnë presion mbi votuesit për të ndikuar në vendimmarrjen e tyre.

Në këtë grup përfshihen edhe punonjës të administratës publike, kryesisht nga OSHEE (Edmond Gorezi dhe Ivi Shazivari). Disa prej tyre mbajnë bexhe të KQZ dhe figurojnë si vëzhgues, por që rrinin brenda ambienteve të disa QV që janë tek Shkolla e Kuqe në Tiranë, ose perballë shkollës, duke vërtetuar dhe orientuar me ore të tëra qytetarët pallateve dhe zones perreth, rreth votimeve. Ky është intimidim dhe patronazhim i paster që ka ndodhur nga këta individë të gjithë të punësuar në shtet apo lidhje me PS, që pasi votojnë vete, rrinë si detyrë “Partie” të ruajnë kush hyn e kush del nga QV e lagjes së tyre... [<https://www.syri.net/politike/787262/banda-e-patronazhisteve-shantazhon-votuesit-tek-shkolla-e-kuqe-ne-tirane-emrat/>]




Nivishkrimi i Ankuestr

Tjetër rast problematik tek Njesia nr. 8 Tirane, tek QV nr. 1937/1 Vezhguesi me kryetaren po benin nje list fshehtas dhe foto bashkengjitur eshte nje nder letrat qe dergoni e mes tyre.

5/ Rastet e dyshuara per Manipulim Procesi me “Tren Bullgar” tek Njesia nr. 9 Tirane [KZAZ nr. 40] dhe Rasti i Fleteve te Votimit me ngjyre te ndryshme nga fletet e votimit zyrtare.

Belind Këlliçi, drejtues politik i PD për Tiranën, ka denoncuar publikisht një rast të manipulimit të votave në KZAZ nr. 40, ku sipas tij është konstatuar fenomeni i njohur si “treni bullgar”. Nga verifikimi i bërë në tavolinat e numërimit nr. 1 dhe nr. 4, janë gjetur fletë votimi me ngjyrë të ndryshme nga standardi dhe të gjitha të palosura në të njëjtën mënyrë, çka sugjeron se janë përgatitur nga e njëjta dorë. Këlliçi deklaroi se këto vota janë hedhur për ministrin e Brendshëm, Ervin Hoxha, dhe përmendi një rast ku një zgjedhës fillimisht votoi gabimisht dhe më pas korrigjoi votën, duke evidentuar kështu diferencën në ngjyrën e fletës së votimit.

Sipas z. Kellici, fletët e dyshimta janë shpallur të pavlefshme me dakordësi nga përfaqësuesit e partive në vend, për shkak të dukshmërisë së manipulimit. Ai shtoi se KZAZ-ja është mbledhur për të shqyrtuar rastin dhe për ta referuar atë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për veprime të mëtejshme. Këlliçi theksoi se manipulimi është i qartë, pasi fletët janë identike në mënyrën si janë palosur, duke ngritur dyshime të forta për një operacion të organizuar me qëllim manipulimin e rezultatit në favor të ministrit të Brendshëm. <https://www.syri.net/politike/787773/treni-bullgar-tek-kzaz-nr-40-kellici-votat-kane-ngjyre-ndryshe-jane-te-palosura-nga-e-njejta-dore-per-ministrin-e-brendshem-ervin-hoxha/>

Ne kemi si pretendim fakti se duhet te Ekzistojne proces-verbale / akt konstatimi te vecanta qe dokumentojne se ato flete duheshin cilesuar si te parregullta. Me pas, cuditerisht, KZAZ me shumicen e Ps vendos te ndryshoje qendrim dhe to vleresoje te rregullta ato pak vota. PD ka dyshime serioze qe aty ne ato QV mund te jete perdorur mekanizmi i manipulimit te votave i njohur si fenomeni Caroussel ose Treni Bullgar.

6/ Rasti i dhunimit te Sekretarit te KZAZ nr. 30 ne Kashar, i propozuar nga PD gjate numerimit te votave te Tiranes si dhe gjetja e nje cante me para ne parkimin para ambienteve te KZAZ ne fjale:

Sipas mediave, lajmi ketu eshte marre nga Gazeta Panorama, shpjegohet se dt 13 Maj një incident i rëndë ndodhi në KZAZ nr. 30 në Kashar, ku një vëzhgues i dyshuar si përfaqësues i Partisë Socialiste, R.N., goditi me grushte dhe shkelma sekretarin e KZAZ-së, Remzi Mehmeti, i Propozuar nga Partia Demokratike, brenda ambienteve të qendrës së numërimit. Policia arrestoi agresorin dhe shpalli në kërkim një tjetër të përfshirë në ngjarje, 40-vjeçarin O.D. Sipas Mehmetit, konflikti nisi kur u kontestua një votë që i përkiste kandidatit të PS-së, Orlando Rakipi, dhe pas përshkallëzimit të debatit, dhuna fizike shpërtheu brenda perimetrit të sigurisë.

Sekretari i KZAZ z.Mehmeti deklaroi për mediat se autorët kaluan vijën e sigurisë dhe e sulmuan fizikisht kur ai kërkoi qetësi dhe zbatimin e procedurës. Ai theksoi se nuk i identifikoi menjëherë autorët, por ka bërë kallëzim penal dhe i ka lënë hetimet në dorë të policisë. Ngjarja solli reagime të forta dhe hodhi dritë mbi tensionet në procesin e numërimit të votave në këtë qendër.

Pas incidentit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) vendosi të revokojë menjëherë akreditimet e të gjithë vëzhguesve në KZAZ nr. 30, duke e konsideruar ngjarjen shkelje të rëndë të etikës dhe sigurisë zgjedhore. Gjithashtu, pranë kësaj qendre u gjet edhe një shumë e konsiderueshme parash në një automjet, duke shtuar dyshimet për parregullsi të mundshme. <https://www.youtube.com/watch?v=Tz4mETnNCqo>




Përnshkrimi / Ankuesit

Lajmi i cantes me para brenda perimetrit te KZAZ e jep edhe Gazeta Shqip : “Ndërkohë, brenda një automjeti që ndodhej në perimetrin e KZAZ-së, është vërejtur një çantë me para, çka ka ngritur dyshime të tjera lidhur me rrethanat e ngjarjes. Autoritetet vijojnë hetimet për të sqaruar të gjithë dinamikën dhe për të identifikuar përgjegjësit”: <https://gazeta-shqip.com/aktualiteti/sherri-ne-kashar-zbulohet-canta-me-para-ne-nje-makine-brenda-perimetrit-te-kzaz-se-ku-numeroohen-votat/>

7/ Problematikat Zgjedhore e evidentuara ne KZAZ NR. 27 (BASHKIA VORË), sipas Strukturave lokale te PD.

Ne Vore, strukturat e PD kane evidentuar keto problematika:

Problematikat gjatë fushatës zgjedhore

Fushata zgjedhore në Bashkinë Vorë është karakterizuar nga një përfshirje e theksuar e administratës publike në mbështetje të kandidatit të Partisë Socialiste. Përveç pjesëmarrjes në takimet elektorale, drejtues të administratës lokale, përfshirë kryetarin e bashkisë dhe drejtorë të ndryshëm, kanë qenë aktivë në veprimtari që bien ndesh me ligjin zgjedhor, përfshirë regjistrimin e votuesve në diasporë. Kjo përfshirje është dokumentuar me foto dhe materiale të shumta nga takime të zhvilluara në Itali, ku drejtues lokalë janë parë në bashkëpunim me struktura të partisë në pushtet për të ndikuar votën e emigrantëve.

Përdorimi i administratës publike

Administrata e bashkisë ka qenë e përfshirë drejtpërdrejt në veprimtari politike, përmes:

- Pjesëmarrjes në takime elektorale;
- Regjistrimit të votuesve në diasporë;
- Intimidimit të votuesve me presione të natyrave të ndryshme;
- Mungesës së ndarjes mes shtetit dhe partisë në pushtet.

Më të spikaturit ishin:

Blerim Shera Kryetari i Bashkisë, Edlira Elezi N/Kryetare e Bashkisë, Alket Mata N/kryetar i Bashkisë, Arlin Papa Drejtor shërbimesh në Bashki, Shkëndie Kuçi Drejtoresh e Spitalit Vorë, Eni Tragaj-Drejtoresh informimi në Bashki, Besjana Subashi e Gersjan Subashi punonjës të Bashkisë, Juljan Kasa inspek IKMT-je, si dhe shumë punonjës të tjerë të bashkisë.

Qendrat e votimit jashtë standardeve ligjore

Janë evidentuar disa qendra votimi që nuk plotësojnë kriteret minimale ligjore për sipërfaqen fizike të ambienteve të votimit, në kundërshtim të hapur me nenin përkatës të Kodit Zgjedhor që kërkon një sipërfaqe minimale prej 36 m² për çdo qendër votimi. Konkretisht:

- QV 2036 (Kodër Bërxull), 1546 dhe 1546-1: Rreth 18 m².
- QV 1549 (Palaq): Rreth 12 m².
- QV 1563 (Sharg): Rreth 9 m².

Për këto dy të fundit është ngritur shqetësimi edhe pranë KQZ-së, por nuk është marrë asnjë masë konkrete për garantimin e kushteve minimale ligjore për zhvillimin e zgjedhjeve.

Presioni ndaj qytetarëve dhe opozitës

Gjatë gjithë fushatës është ushtruar presion i vazhdueshëm ndaj qytetarëve, përmes:

- Lejimit të ndërtimeve pa leje në këmbim të mbështetjes elektorale;
- Marrjes së pagesave informale;



[Signature]
Nënkryetar i Ankuesit

- Kërkesave të drejtpërdrejta për dhënien e votës;
- Moslejimit të hapjes së zyrave elektorale nga opozita;
- Frikësimit të pronarëve të lokaleve për të mos lejuar takime të opozitës, si në rastin konkret të zonës së Marqinetit.

Aktivitetet e grupeve të presionit (“Xhabaftët”)

Në zonat e Vorës, Marikajt, Picarit, Berxullit dhe Gjokajt janë evidentuar grupe individësh të njohur si “Grupi Xhabaftëve”, të cilët kanë ushtruar trysni të hapur ndaj votuesve dhe strukturave të opozitës, duke krijuar një klimë frike dhe pasigurie. (emrat e të cilëve janë përmendur para datës së zgjedhjeve nga Znj. Vokshi dhe Z. Strazimiri në konferencën e mbajtur pranë selisë së PD). Në dijenin tonë për këto emra është bërë kallzim, si dhe është adresuar si problem dhe BE-së.

Dita e zgjedhjeve – Patronazhistët dhe administrata

Gjatë ditës së votimit, patronazhistë të partisë në pushtet dhe punonjës të administratës qëndronin në të gjitha hyrjet e qendrave të votimit duke intimiduar votuesit. Ata shoqëronin qytetarët deri brenda ambienteve të votimit dhe nuk respektonin asnjë standard ligjor të ndarjes së politikës nga procesi zgjedhor.

Edhe kur njoftohet policia, ndërhyrja e saj ishte e vonuar, dhe në mënyrë të dyshimtë, personat përgjegjës largoheshin pak minuta para mbërritjes së efektivëve.

Pajisja e administratës me badge “STAF” nga KQZ

Një numër i konsiderueshëm i punonjësve të administratës lokale u pajisën me badge “STAF” nga KQZ-ja, duke i lejuar të lëviznin lirisht në qendrat e votimit. KQZ-ja, nuk bëri një prononcim nëse ishin lëshuar nga to apo jo, nëse po, përse u pais administrata dhe patronazhistët me to? Këta individë shoqëronin votuesit dhe i orientonin në mënyrë të njëanshme, duke cënuar barazinë dhe lirinë e votës.

8) Raport mbi problematikat e konstatuara gjatë procesit zgjedhor në Degën 16, Tiranë

Në vijim të zhvillimit të Zgjedhjeve Parlamentare të datës 19 maj 2025, Dega 16 e Partisë Demokratike në Tiranë paraqet një përmbledhje të problematikave kryesore të evidentuara gjatë procesit zgjedhor në territorin e saj administrativ. Këto çështje përbëjnë shkelle të standardeve zgjedhore dhe kërkojnë vëmendjen e institucioneve përkatëse për hetim dhe ndëshkim, sipas ligjit.

Prani e zyrtarëve të lartë të Bashkisë së Tiranës në qendrat e votimit

Është konstatuar prania e z. Adriatik Merko, drejtor në Bashkinë e Tiranës, në qendrat e votimit nr. 1880 deri në 1880/3, së bashku me individë të tjerë me lidhje me pushtetin vendor. Gjithashtu te qendrat e votimit ,1881-1881/3 ka qendruar gjatë gjithë kohës së votimit Klejdim Cela, drejtor dhe njeri i afert I Blendi Gonxhes. Kjo prani ka krijuar presion të perceptueshëm ndaj votuesve dhe përbën intimidim të drejtpërdrejtë në ambientet zgjedhore.

Zhvendosje selektive e votuesve të opozitës

Janë evidentuar raste ku qytetarëve të identifikuar si mbështetës të opozitës u është ndryshuar qendra e votimit, duke u zhvendosur në zona të tjera më të largëta nga vendbanimi (nga qendra 1537 në qendrën 1880), duke vështirësuar aksesin në votim dhe duke ndikuar në pjesëmarrjen e tyre.



Prani e drejtuesve të administratës publike pranë qendrave të votimit


 Përkrahje / Ankuesit

Në zonën e Bulevardit "Migjeni", ku ndodhen qendrat e votimit nr. 1537, janë konstatuar persona që mbajnë poste drejtuese në administratën publike, duke qëndruar në mënyrë të pajustificuar në afërsi të qendrave të votimit dhe duke ushtruar ndikim të mundshëm mbi zgjedhësit.

Zyra jozyrtare me funksion elektoral në zonën e Astirit

Në zonën e Astirit është identifikuar një ambient që funksiononte si zyrë elektorale pa asnjë logjikë zyrtare apo autorizim, ku kanë qenë të pranishëm punonjës të administratës. Ky fakt është bërë publik edhe nga deputeti Klevis Balliu në disa media ditën e zgjedhjeve.

Fotografimi i votuesve nga persona me lista në dorë

Pranë shkollës "Kongresi i Manastirit" janë parë persona të panjohur që mbanin lista në dorë dhe fotografonin qytetarët që hynin për të votuar, duke cënuar fshehtësinë dhe lirinë e votës dhe duke ndikuar në atmosferën e besimit në proces.

Dhunimi i përfaqësuesit të PD në KZAZ nr. 30

Z. Remzi Mehmetaj, përfaqësues i Partisë Demokratike dhe sekretar i KZAZ nr. 30, është dhunuar gjatë ushtrimit të detyrës brenda ambienteve të KZAZ nga vëzhgues të një kandidati të Partisë Socialiste. Ky është një rast i rëndë që kërkon hetim të menjëhershëm dhe ndëshkim penal.

Përdorimi elektoral i punëve publike në ditët para zgjedhjeve

Në disa lagje të zonës janë kryer ndërhyrje infrastrukturore (shtirim rrugësh) vetëm pak ditë para votimeve, gjë që përbën përdorim të burimeve shtetërore për përfitime elektorale dhe cënim të parimeve të barazisë në garë.

9/ Disa nga problematikat e konstatuara nga Dega nr. 5 Tirane e PD:

- Në KZAZ nr. 36 nuk është dokumentuar inventari i fletëve të votimit. Në rastin konkret të QV 1816/1, fletët e papërdorura nuk u vendosën në kutinë për materialet e votimit, dhe kjo shkelje nuk u evidentua apo u pasqyrua nga vetë KZAZ-ja.
- Vëzhgues që duhej të qëndronin brenda qendrës së votimit u panë duke ndërhyrë jashtë saj, ku ndalonin dhe orientonin votuesit, madje duke i shoqëruar deri në hyrje, në kundërshtim me rolin e tyre ligjor.
- Në Njësinë nr. 5 janë evidentuar disa raste ku punonjës të administratës publike qëndronin brenda qendrave të votimit, duke u prezantuar herë si vëzhgues dhe herë si orientues të votuesve. Veprimtaria e tyre linte të kuptohej qartë se ishin të angazhuar në një mision kontrolli votash dhe patronazhimi, në shkelje të parimeve të integritetit të procesit zgjedhor.

Megjithëse problematikat tepër shqetësuese të evidentuara në Qarkun Tiranë, përbëjnë një cënim serioz të integritetit të procesit zgjedhor dhe ndikojnë drejtpërdrejt në vlefshmërinë e tij në nivel rajonal dhe kombëtar, problematika më e rëndë e zgjedhjeve të 11 majit mbetet procesi i votimit të Diasporës.

Ky proces, i cili përbën "thembrën e Akilit" të këtyre zgjedhjeve të kontestuara, ndonëse formalisht i mbështetur në një bazë kushtetuese dhe ligjore, ka rezultuar në mënyrë evidente si një dështim total në vlerësimin tonë, për shkak të mangësive të rënda në zbatimin praktik.




Mëshkrimi i Ankuesit

Në lidhje me këtë çështje madhore, do të parashtrojmë në vijim argumentet dhe sqarimet tona të detajuara. Megjithatë, është fakt i pakundërshtueshëm se, në ditën e shqyrtimit të ankesave, as Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe as kompania postare ndërkombëtare DHL ka deshtuar të vendosi në dispozicion prova që të vërtetojë përmbushjen e plotë të detyrimit ligjor për dërgimin e zarfeve me fletët e votimit në adresën e regjistruar në KQZ për secilin votues të regjistruar nga Diaspora, kundrejt paraqitjes prej secilit prej tyre të një mjeti identifikimi dhe kundrejt nënshkrimit personal të secilit zgjedhës. Perkundrazi, dita ditës dalin në pah prova dhe evidenca që vëne në dyshim dhe pikepyetje serioze procesin e dërgimit dhe sidomos kthimit pas të zarfave nga DHL. Vetëm pak orë para mbylljes së ankimit për Qarkun Tiranë, në media u publikua rasti i një simpatizanti /militanti të PS, i cili punonte në magazinën e DHL jashtë shtetit dhe ku postonte foto e video gjatë procesit të punës së tij pikerisht me zarfat dhe fletët e votimit, ku nuk ngurronte të aludonte se mund të plotesonte votat. Ky fakt i publikuar në rrjetin e tij social nga ky individ, shoqëruar edhe nga komentet ku ai përgjigjej se ai “plotesonte” dhe një shtetas tjetër shqiptar (koleg?) i tij kryente një tjetër proces pune (paketim?), nese shihen edhe me postimet e tjera të këtij individi, në shumë aktivitete publike në diasporë të PS, dhe me foto se bashku me drejtuesin politik për Diasporën të PS, vecse njollosin me hije shumë të renda dyshimi procesin e votimit të Diaspores.

Në vijim, po analizojmë të faktet, argumentat dhe dispozitat ligjore ku mbështetet ankimi.

FAKTET, ARGUMENTAT, DISPOZITAT LIGJORE KU MBËSHTETET ANKIMI.

Referuar Nenit 160 “Pavlefshmëria e zgjedhjeve në qendrën e votimit” parashikon se:

“1. KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një apo më shumë qendra votimi, në rast se:

a) kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor ose kur tërësia e shkeljeve të ligjit, sipas kësaj shkronje, të ndodhura në ato qendra votimi mund të ketë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore;

b) kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim; ose

c) votimi nuk ka filluar apo është pezulluar për më shumë se pesë orë.

2. Subjektet zgjedhore, në përputhje me rregullat dhe afatin e përcaktuar në nenin 124 të këtij Kodi, kanë të drejtë të kërkojnë në KQZ shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në qendra të caktuara votimi.

3. Kërkesa për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve duhet të përmbajë shkaqet ligjore përshkrimin e rasteve të shkeljeve dhe arsyetimin e detajuar për pasojën e tyre.

4. Shqyrtimi i kërkesave bëhet sipas procedurave të përcaktuara në pjesën X të këtij Kodi. KQZ-ja, në marrjen e vendimit për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, mund konsultohet me KZAZ-në përkatëse. Në arsyetimin e vendimit të KQZ-së duhet të përshkruhet shkaku ligjor, rastet e vërtetuara të shkeljeve dhe arsyetimi i detajuar për pasojën e tyre”.

Referuar Nenit 161 “Përsëritja e zgjedhjeve” :

“1. Pas përfundimit të procesit të ankimit, jo më vonë se 3 ditë nga nxjerrja e rezultatit të zonës zgjedhore, KQZ-ja kryesisht ose me kërkesë të subjektit, shpall të pavlefshme dhe urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore, kur pavlefshmëria e shpallur në një ose disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi, ndikon në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore ose në shkallë vendi.

